

# Standardi i kualifikimit me bazë rajonale për Teknikun Bujqësor të Kultivimit Tradicional dhe Organik - SKTBKTO

Ky standard u përgatit në kuadër të projektit *Përmirësimi i Cilësisë së Arsimit dhe Formimit në EJL – EQET SEE*<sup>1</sup> nga përfaqësuesit e 6 ekonomive pjesëmarrëse: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova\*<sup>2</sup>, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Serbia.

## Pjesa I - Informacion i përgjithshëm

Standardi i kualifikimit	
1. Titulli i kualifikimit	<p>Teknik bujqësor i kultivimit tradicional dhe organik</p> <p>Shqipëri: Bujqësi Tradicionale dhe Organike (TBC)            BeH: Agrotehničar organske i tradicionalne proizvodnje            Kosovë*: TBC            Mali i Zi: Agrotehničar            Maqedoni e Veriut: Agrotehničar            Serbi: Poljoprivredni tehničar</p>
2. Lloji i kualifikimit	<p>Ky kualifikim është kualifikim <b>i plotë</b>.            Kualifikimi në fjalë mund të përftohet <b>në sistemin e arsimit dhe formimit fillestar profesional</b>, në <b>arsimin dhe formimin e të rriturve</b> ose mund të akordohet në sistemin e <b>validimit të të nxëniet informal dhe joformal</b> me cilësi të garantuar.</p>
3. Përshkrimi/justifikimi/arsyetimi i kualifikimit, nevoja për këtë kualifikim	<p>Tekniku bujqësor i kultivimit tradicional dhe organik (TBKTO) planifikon, organizon dhe koordinon prodhimin bimor e blegtoral dhe kryen përpunimin bazë të produkteve parësore.</p> <p>TBKTO përdor teknologjitë e duhura dhe përkatëse në bujqësi, në aktivitetet për rritjen e perimeve, në pemëtari, vreshtari dhe blegtori.</p> <p>TBKTO organizon dhe kryen përpunimin bazë, përfundimin, paketimin dhe ruajtjen e produkteve me origjinë bimorë dhe shtazore në mënyrë ekologjike të qëndrueshme. Ai/ajo është i/e përfshirë në prokurimin dhe tregtimin e produkteve.</p> <p>Agrotekniku zbaton standardet dhe normat e prodhimit tradicional, organik, konvencional dhe integral dhe zbaton masat për mbrojtjen e mjedisit, shëndetit dhe vendit të punës, duke garantuar respektimin e standardeve të cilësisë në punën e tij.</p> <p>TBKTO komunikon me eprorët dhe kolegët duke zbatuar rregullat e komunikimit të biznesit në mënyrë etike dhe profesionale, në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. TBKTO planifikon dhe zbaton aktivitetet e marketimit në mënyrë të pavarur dhe në ekip.</p> <p>Ai/ajo ndjek trendet, arritjet, teknologjitë e reja (përfshirë TIK-un) dhe i</p>

<sup>1</sup> Për më shumë informacion në lidhje me projektin, vizitoni faqen e internetit të projektit <https://eqet.erisee.org/>

<sup>2</sup> \* Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet mbi statusin e vendit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KSKB-së dhe Opininionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.



	<p>zbaton ato në proceset e punës dhe të prodhimit në sajë të zhvillimit të vazhdueshëm profesional.</p> <p>Ky kualifikim është i vlefshëm në të gjithë rajonin, pasi bazohet në standardin e profesionit të dakorduar në rang rajonal dhe të përgatitur në bashkëpunim me agjencitë rajonale të AFP-së.</p>																					
<p><b>4. Standardet përkatëse të profesioneve, lidhja me klasifikimin ISCO ose çdo të dhënë tjetër në lidhje me konsultimin me palët e interesit të tregut të punës</b></p>	<p>Standardi i profesionit me bazë rajonale, Teknik Bujqësor i Kultivimit Tradicional dhe Organik, është përdorur si bazë për zhvillimin e këtij standardi kualifikimi me bazë rajonale.</p> <p>ISCO 3142 Teknik bujqësor 6130 Prodhuesit e përzier të kulturave dhe kafshëve</p>																					
<p><b>5. Niveli i kualifikimit (KEK)</b></p>	<p>Niveli në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për Të Nxënit gjatë Gjithë Jetës (KEK 1-8): 4</p>																					
<p><b>6. Vlera e krediteve të kualifikimit ose vitet/orët e kohëzgjatjes dhe përqindja e njësive të arsimit të përgjithshëm në kualifikimin e përgjithshëm</b></p>	<p>Ky kualifikim mbulon një gamë prej 100-140 ECVET ose 1500-3000 orë të nevojshme për një individ për arritjen e rezultateve të të nxënit për këtë kualifikim. Ai përfshin si periudhën e induksionit ashtu edhe kohën e përfshirjes në procesin e të nxënit dhe kualifikimit jashtë klasës.</p> <p>Një ECVET në nivel rajonal duhet të përkthehet në 15 – 25 orë (sipas Rekomandimeve të BE-së, ku një orë është e barasvlefshme me 60 minuta).</p> <p>Kreditet ECVET akordohen vetëm për pjesën profesionale të standardit të kualifikimit.</p> <p>Përqindja e komponentëve profesionalë dhe përqindja e arsimit të përgjithshëm brenda një kualifikimi si element i një standardi kualifikimi për secilën ekonomi:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Ekonomia</th> <th>Përqindja e njësive të rezultateve të të nxënit të arsimit profesional në vëllimin e përgjithshëm të kualifikimit</th> <th>Përqindja e njësive të rezultateve të të nxënit të arsimit të përgjithshëm në vëllimin e përgjithshëm të kualifikimit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Shqipëri:</td> <td>60%</td> <td>40%</td> </tr> <tr> <td>BeH:</td> <td>60%</td> <td>40%</td> </tr> <tr> <td>Kosovë*:</td> <td>63%</td> <td>37%</td> </tr> <tr> <td>Mali i Zi:</td> <td>56%</td> <td>44%</td> </tr> <tr> <td>Maqedonia e Veriut:</td> <td>55-60%</td> <td>40-45%</td> </tr> <tr> <td>Serbi:</td> <td>55-60%</td> <td>40-45%</td> </tr> </tbody> </table>	Ekonomia	Përqindja e njësive të rezultateve të të nxënit të arsimit profesional në vëllimin e përgjithshëm të kualifikimit	Përqindja e njësive të rezultateve të të nxënit të arsimit të përgjithshëm në vëllimin e përgjithshëm të kualifikimit	Shqipëri:	60%	40%	BeH:	60%	40%	Kosovë*:	63%	37%	Mali i Zi:	56%	44%	Maqedonia e Veriut:	55-60%	40-45%	Serbi:	55-60%	40-45%
Ekonomia	Përqindja e njësive të rezultateve të të nxënit të arsimit profesional në vëllimin e përgjithshëm të kualifikimit	Përqindja e njësive të rezultateve të të nxënit të arsimit të përgjithshëm në vëllimin e përgjithshëm të kualifikimit																				
Shqipëri:	60%	40%																				
BeH:	60%	40%																				
Kosovë*:	63%	37%																				
Mali i Zi:	56%	44%																				
Maqedonia e Veriut:	55-60%	40-45%																				
Serbi:	55-60%	40-45%																				
<p><b>7. Sektori/ fusha e punës (sipas ISCED)</b></p>	<p>Klasifikimi i kualifikimit sipas klasifikimit EUROSTAT ISCED-F (FOET – Fushat e Arsimit dhe Formimit)</p> <p>08 Bujqësi, pylltari, peshkim dhe veterinar 081 Bujqësi 0811 Prodhimi bimor dhe blegtoral</p>																					



<p><b>8. Kërkesat specifike për sigurimin e cilësisë në lidhje me kualifikimin</b></p>	<p>Standardi i kualifikimit për Teknikun Bujqësor të Kultivimit Tradicional dhe Organik do të zhvillohet më tej në nivel kombëtar nga ekonomitë pjesëmarrëse në proces, duke ndjekur metodologjinë e tyre kombëtare. Ky standard kualifikimi me bazë rajonale për teknikët bujqësorë të kultivimit tradicional dhe organik do të përbëjë thelbin e standardeve kombëtare të kualifikimit të zhvilluara më pas. Për të garantuar cilësinë e standardeve kombëtare të kualifikimit, duhet të ndiqen procedurat kombëtare (miratimi nga organet përkatëse, monitorimi i zbatimit nga organet përkatëse dhe certifikimi i pjesëmarrësve në arsim).</p>
<p><b>9. Kërkesat e pranimit/ hyrjes/ parakushtet për marrjen e kualifikimit</b></p>	<p>Kërkesa minimale për hyrje në kualifikimin Teknik Bujqësor për Kultivimin Tradicional dhe Organik për sa i përket kualifikimit paraprak që duhet të përftohet është arsimi bazë ose kualifikimi i nivelit 1 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. Kërkesat e tjera lidhen me legjislacionin e parashikuar të secilës prej ekonomive.</p>
<p><b>10. Përparimi/përshkueshmëria në sistemin e kualifikimit/mundësitë e mëtejshme për kualifikim dhe punësim</b></p>	<p>Pas përfundimit të kualifikimit, nxënësit i hapen mundësitë e mëposhtme: <b>Punësim:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vetëpunësim</li> <li>• punësim në kombinat bujqësor, kooperativa bujqësore ose në njësi bujqësore individuale</li> </ul> <p><b>Përshkueshmëria vertikale:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vazhdimi i arsimit pas të mesëm</li> <li>• vazhdimi i arsimit të lartë në fushën përkatëse ose fusha të tjera nëse paraprakisht merret një certifikatë e përcaktuar me ligj.</li> </ul> <p><b>Përshkueshmëria horizontale:</b> Për regjistrimin në një program tjetër mësimor, merren parasysh modulet (sektoriale dhe të përgjithshme) e kurrikulës për kualifikimin Teknik Bujqësor për Kultivimin Tradicional dhe Organik dhe modulet e kurrikulës së programit të ri.</p>
<p><b>11. Struktura e kualifikimit: Lista e njësive të detyrueshme të rezultateve të të nxënës dhe njësive me zgjedhje të rezultateve të të nxënës</b></p>	<p><b>Njësitë e detyrueshme të rezultateve të të nxënës janë:</b> NJËSIA 1 - Organizimi/Menaxhimi i prodhimit bujqësor NJËSIA 2 - Mekanizimi, automatizimi dhe pajisjet NJËSIA 3 - Kushtet për prodhimin bujqësor NJËSIA 4 - Prodhimi i bimëve njëvjeçare (kulturat fushore dhe perimet/produktet bujqësore) NJËSIA 5 - Prodhimi i bimëve shumëvjeçare (frutikultura dhe vreshtaria) NJËSIA 6 - Prodhimi blegtoral dhe kujdesi për kafshët NJËSIA 7 - Përpunimi dhe ruajtja e produkteve ushqimore parësore (produkte bimore dhe blegtorale) NJËSIA 8 - Komunikimi me bizneset dhe sipërmarrja në bujqësi NJËSIA 9 - Standardet, mbrojtja e mjedisit dhe siguria në punë</p> <p><b>Njësitë e mundshme me zgjedhje të rezultateve të të nxënës janë:</b> NJËSIA 1 - Bletari NJËSIA 2 - Kultivimi i kërpudhave NJËSIA 3 - Bimët foragjere NJËSIA 4 - Kultivimi i bimëve mjekësore, aromatike dhe erëzave/ Kultivimi i bimëve mesdhetare NJËSIA 5 - Peshkimi NJËSIA 6 - Kultivimi i luleve</p>



	<p>NJËSIA 7 - Agroturizmi NJËSIA 8 - Përpunimi më kompleks për produkte specifike bimore (p.sh., ullinj, manaferra, çajra, etj.) NJËSIA 9 - Përpunimi më kompleks i produkteve specifike me origjinë shtazore (p.sh. djathëra dhe produkte të tjera qumështi, mishi i përpunuar, etj.)</p>
<p><b>12. Dakordimi për standardin e kualifikimit me bazë rajonale</b></p>	<p>Procesi për përgatitjen e standardit të kualifikimit për teknikun bujqësor të kultivimit tradicional dhe organik zgjati nga data 1 korrik deri më 31 tetor 2022. Secila ekonomi përfaqësohej nga një ekip me 2 anëtarë, pjesë e agjencisë përgjegjëse për AFP-në/Standardet e Kualifikimeve, ku njëri prej tyre është njëkohësisht ekspert për Standardet e Profesioneve/Standardet e Kualifikimeve dhe përfaqësuesi tjetër është ekspert me njohuri dhe aftësi specifike për sektorin (anëtar i grupit kombëtar të punës për standardet e kualifikimeve).</p> <p>Puna për zhvillimin e Standardit të Kualifikimit u bazua në Standardin e Profesionit të zhvilluar në nivel rajonal për Teknikun Bujqësor të Kultivimit Tradicional dhe Organik. Puna e përbashkët në nivel rajonal u organizua në formën e seminareve të punës, bazuar në materialet e përgatitura në bashkëpunim me përfaqësuesit e të gjitha ekonomive dhe në komentet e paraqitura në lidhje me materialet e përgatitura gjatë këtyre seminareve. Gjithashtu, në këto aktivitete u dakorduan edhe parimet kryesore për zhvillimin e Standardit të Profesionit si dhe u garantua njohja dhe interpretimi i përbashkët i Metodologjisë së zhvilluar dhe të dakorduar në nivel rajonal për zhvillimin e Standardit të Kualifikimit.</p> <p>Duke pranuar dhe njohur specifikat e secilës prej ekonomive në lidhje me zhvillimin e kualifikimeve, ky standard kualifikimi i zhvilluar në nivelin e EJL-së shërben si një trung i përbashkët për të gjitha ekonomitë. Standardi i kualifikimit i përgatitur për teknikun bujqësor të kultivimit tradicional dhe organik do të bëjë të mundur arritjen e rezultateve të të nxëniet të dakorduara në secilën prej ekonomive.</p>



## Pjesa II -Pjesa specifike e kualifikimit


NJËSITË E REZULTATEVE TË TË NXËNIT	NIVEL I	ECVET	REZULTATET E TË NXËNIT
<p>NJËSIA 1 Organizimi/Menaxhimi i prodhimit bujqësor</p>	<p>KEK 4</p>	<p>ECVET 10- 14</p>	<p>1.1. Bën planifikimin dhe organizimin e punës së vet dhe të ekipit të punëtorëve në fushën e punës, në përputhje me rregullat e profesionit, detyrën e punës dhe risitë në prodhimtarinë bujqësore.</p> <p>1.2. Përgatit burimet dhe vendin e punës për punë bujqësore, në përputhje me aktivitetet e planifikuara dhe detyrën e punës.</p> <p>1.3. Plotëson dokumentacionin e duhur të punës.</p> <p>1.4. Përdor të dhënat dhe tendencat meteorologjike, agroekologjike dhe ekonomike gjatë planifikimit.</p> <p>1.5. Përgatit planin e rotacionit të kulturave dhe prodhimit. 1.5.1. Përgatit planin e rotacionit të kulturave, duke përfshirë patatet, në lidhje me kushtet agroekologjike dhe shpjegoni procesin e përgatitjes të tij.</p> <p>1.6. Bën koordinimin, organizimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e të gjitha proceseve të punës prodhuese dhe përpunuese në bujqësi. 1.6.1. Organizoni punën e një grupi punëtorësh për mbjelljen e perimeve tuberoze/ me zhardhokë dhe kontrolloni procesin teknologjik në përputhje me standardet e prodhimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Planifikoni buxhetin e duhur. (Koha për buxhetin përcaktohet nga komisioni pas hartimit të detyrës specifike. Kjo kohë nuk përfshihet në kohën totale të krijimit të detyrës së punës.)</li> <li>Si pjesë e përgatitjes me shkrim, specifikoni mjetet dhe materialin e nevojshëm teknik, përshkruani planin për krijimin e detyrës së punës (rendi i punimeve dhe kohëzgjatja e parashikuar), rregullimin dhe kontrollin e parametrave teknologjikë.</li> <li>Gjatë krijimit të detyrës vlerësohet organizimi i punës, kryerja e çdo faze të procedurës teknologjike, mbajtja e shënimeve, zbatimi i masave higjienike dhe mbrojtëse dhe koha e krijimit.</li> <li>Koha e krijimit të detyrës së punës është 75 minuta nga momenti i marrjes në dorëzim të mjeteve dhe materialeve teknike, duke përfshirë procesverbalet. Përfundimi i detyrës brenda 45 minutash i jep kandidatit 10 pikë, deri në 60 minuta 5 pikë, ndërsa për përfundimin e detyrës për më shumë se 60 minuta nuk fitohet asnjë pikë. Pas 75 minutash, ekzekutimi i detyrës së punës ndërpritet.</li> </ul>



<p>NJËSIA 2 Mekanizimi, automatizimi dhe pajisjet</p>	<p>KEK 4</p>	<p>ECVET <b>10-14</b></p>	<p>2.1. Zgjedh makineritë, pajisjet dhe veglat e punës për punën bazë dhe atë shtesë në bazë të procesit të punës.</p> <p>2.2. Kontrollon gatishmërinë teknike dhe konfigurimin e nevojshëm të makinerive, pajisjeve, veglave dhe agregateve të tyre.</p> <p>2.3. Zbaton masat agroteknike me makineri dhe pajisje të përshtatshme në proceset e prodhimit bujqësor.</p> <p>2.4. Përdor makineritë dhe pajisjet në procesin e prodhimit blegtoral në mënyrën e duhur. 2.4.1. <i>Shpjegoni parimin e punës dhe demonstroi punën me sistemin robotik për regjistrin bazë, ushqyerjen dhe mjeljen e lopëve.</i></p> <p>2.5. Mbikëqyr pastrimin, dezinfektimin dhe mirëmbajtjen e makinerive bujqësore, pajisjeve, mjeteve, veglave dhe agregateve.</p> <p>2.6. Zbaton procedurat për magazinimin dhe ruajtjen e makinerive gjatë kohës që nuk janë në punë. 2.6.1. <i>Demonstroi procedurën e pastrimit, vajosjes, ruajtjes dhe magazinimit të aksesorit/pajisjes shtesë, p.sh.: levës së timonit, në kushte të përshtatshme gjatë kohës që nuk është në punë.</i></p>																																																						
<p>NJËSIA 3 Kushtet për prodhimin bujqësor</p>	<p>KEK 4</p>	<p>ECVET <b>10-14</b></p>	<p>3.1 Përdor të dhënat e dala nga analiza e kushteve agrometeorologjike dhe hidrologjike për të përzgjedhur llojet dhe varietetet e kulturave bujqësore për kultivim. Dhe 3.4. <i>Përcaktoni masat e nevojshme agroteknike për rregullimin e tokës për mbjelljen e mollës, bazuar në analizat pedologjike të kryera më parë dhe në analizat e kushteve agrometeorologjike në zonën e caktuar.</i> <i>Përcaktoni metodën dhe thellësinë e kultivimit të tokës.</i> <i>Përcaktoni llojet dhe normat e plehërimit për plehërimin bazë të tokës përpara vendosjes së kulturave shumëvjeçare.</i> <i>Analizoni kushtet agrometeorologjike bazuar në të dhënat e marra më parë.</i></p> <table border="1" data-bbox="635 1637 1337 1977"> <thead> <tr> <th colspan="7">Analiza pedologjike</th> </tr> <tr> <th colspan="7">Instituti Bioteknik i Malit të Zi</th> </tr> <tr> <th>Thellësia</th> <th colspan="2">Ph</th> <th>CaCO<sub>3</sub></th> <th>IDG</th> <th>Humus</th> <th>P<sub>2</sub>O<sub>5</sub></th> <th>K<sub>2</sub>O</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>cm</td> <td>Në H<sub>2</sub>O</td> <td>Në 1 N KCl-u</td> <td>%</td> <td>%</td> <td>%</td> <td>mg/100 g dhë</td> <td></td> </tr> <tr> <td>0-30</td> <td>5,65</td> <td>5,08</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>7,65</td> <td>1</td> <td>5,9</td> </tr> <tr> <td colspan="7">Reagimi i tokës (pH në 1N KCl): acidike</td> <td></td> </tr> <tr> <td colspan="7">Karbonatet në total: gëlqerore shumë të dobëta</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Analiza pedologjike							Instituti Bioteknik i Malit të Zi							Thellësia	Ph		CaCO <sub>3</sub>	IDG	Humus	P <sub>2</sub> O <sub>5</sub>	K <sub>2</sub> O	cm	Në H <sub>2</sub> O	Në 1 N KCl-u	%	%	%	mg/100 g dhë		0-30	5,65	5,08	0	0	7,65	1	5,9	Reagimi i tokës (pH në 1N KCl): acidike								Karbonatet në total: gëlqerore shumë të dobëta							
Analiza pedologjike																																																									
Instituti Bioteknik i Malit të Zi																																																									
Thellësia	Ph		CaCO <sub>3</sub>	IDG	Humus	P <sub>2</sub> O <sub>5</sub>	K <sub>2</sub> O																																																		
cm	Në H <sub>2</sub> O	Në 1 N KCl-u	%	%	%	mg/100 g dhë																																																			
0-30	5,65	5,08	0	0	7,65	1	5,9																																																		
Reagimi i tokës (pH në 1N KCl): acidike																																																									
Karbonatet në total: gëlqerore shumë të dobëta																																																									



Karbonatet aktive (IDG): brenda kufijve normalë		
Humusi: Sasi e madhe humusi		
Fosfori i aksesueshëm: përmbajtje e ulët		
Kaliumi i aksesueshëm: përmbajtje e ulët		



3.2 Përdor të dhënat nga analiza e kushteve agrometeorologjike dhe hidrologjike për të planifikuar prodhimin blegtoral.

3.3. Merr mostrat e tokës dhe ujit për analiza kimike.

3.4 Përdor të dhënat e analizës pedologjike (vetitë biologjike, kimike dhe mekanike) të tokës për të vendosur prodhimin.

3.5 Zbaton masat për parandalimin e ndikimit të kushteve të pafavorshme agrometeorologjike (si p.sh., reshjet e shiut, temperaturat e ulëta, temperaturat e larta, thatësira, era, etj.).  
3.5.1. Zgjidhni një metodë që mund të përdoret për të parandaluar ndikimin negativ të temperaturave të ulëta (ngricës) në kulturat e panxharit ose maruleve. Shpjegoni arsyen e zgjedhjes së metodës dhe aplikimin e saj.

3.6. Aplikon masa adaptive në procesin e prodhimit për shkak të ndryshimeve klimatike.

**NJËSIA 4**  
Prodhimi i bimëve njëvjeçare (kultura fushore dhe perime/bujqësore)

**KEK 4**  
**ECVET**  
**20 - 28**

4.1. Kryen procesin e punimit dhe plehërimit të tokës.  
4.1.1.a Zgjidhni makineritë dhe pajisjet lidhëse të përshtatshme, kryeni procesin e rregullimit, sipas kërkesave që lidhen me kulturën e patates ose grurit dhe kryeni kultivimin bazë të tokës.  
4.1.2. Zgjidhni pajisjet e duhura lidhëse, kryeni procesin e rregullimit, sipas kërkesave që lidhen me kulturën e patates ose grurit dhe kryeni përpunimin shtesë të tokës.  
4.1.3. Propozoni plehërimin bazë të tokës bazuar në analizat dhe kërkesat për kulturën e patates ose grurit që do të prodhohet.



			<p>4.2. Prodhon farërat e kulturave dhe materialin bimor të fidanëve.</p> <p>4.2.1. Zgjidhni farërat sipas kushteve ekologjike të zonës së kultivimit dhe karakteristikave biologjike të grurit ose të grurit organik.</p> <p>4.2.2.a Verifikoni karakteristikat dhe cilësinë e farërave të grurit si material farë.</p> <p>4.2.2.b Verifikoni karakteristikat dhe cilësinë e materialit mbjellës të patates.</p> <p>4.2.2.c Përgatisni farërat e grurit për prodhim organik.</p> <p>4.2.2.d Përgatisni materialin mbjellës të patateve për mbjellje.</p> <p>4.3. Kryen aktivitete të ndryshme përgatitore dhe zbaton metoda kultivuese për mbjelljen e farërave dhe fidanëve në fusha dhe në mjedis të mbrojtur/kontrolluar duke përdorur mjetet e përshtatshme të punës në përputhje me standardet dhe rregulloret.</p> <p>4.4. Aplikon masat e kujdesit për kulturat e arave/fushore në përputhje me teknologjinë më të fundit të kultivimit në fushë dhe në mjedis të mbrojtur/kontrolluar.</p> <p>4.5. Kryen vjeljen, paketimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe bimore, në përputhje me standardet dhe rregulloret për prodhimin bujqësor dhe perimor.</p>
<p>NJËSIA 5 Prodhimi i bimëve shumëvjeçare (frutikulturë dhe vreshtari)</p>	<p>KEK 4</p>	<p>ECVET 15 - 21</p>	<p>5.1. Zbaton procedurën për përgatitjen e ngritjes së plantacioneve në përputhje me standardet dhe teknologjinë e prodhimit.</p> <p>5.1.1. Zgjidhni frutin e përshtatshëm për mbjellje duke u bazuar në të dhënat në lidhje me karakteristikat fiziko-kimike të tokës dhe përshkruani arsyen e përzgjedhjes.</p> <p>5.1.2. Shpjegoni me argumente përdorimin e mjeteve dhe procedurave të nevojshme për ngritjen e plantacionit sipas hardhive p.sh. Shesh i bardhë, Shesh i zi.</p> <p>5.2. Prodhon material bimor për fidanët e frutave dhe rrushit.</p> <p>5.2.1. Zgjidhni llojin e tokës për prodhimin e fidanëve të mollës Starking sipas kërkesave biologjike.</p> <p>5.2.2. Zbatoni teknikën më të përshtatshme për prodhimin e fidanëve të hardhisë sipas kushteve pedo-klimatike.</p> <p>5.3. Zbaton procedurën për rritjen e plantacioneve në përputhje me standardet dhe teknologjinë e prodhimit.</p> <p>5.4. Zbaton masat për mirëmbajtjen e bimëve shumëvjeçare deri në periudhën e frutdhënies.</p> <p>5.5. Zbaton masat agroteknike për kultivimin e bimëve shumëvjeçare gjatë periudhës së frutdhënies.</p>





			5.6. Organizon vjeljen, grumbullimin, transportin dhe ruajtjen e frutave dhe rrushit.
NJËSIA 6 Prodhimi blegtoral dhe kujdesi ndaj kafshëve	KEK 4	ECVET 15 - 21	<p>6.1. Përgatit kushtet për rritjen e kafshëve shtëpiake sipas racës dhe kategorisë.</p> <p>6.1.1. Përgatit kushtet e përshtatshme hapësinore dhe ambientale për rritjen e lopëve/deleve/dhive qumështore dhe pulave.</p> <p>6.2. Siguron ushqyerjen e kafshëve shtëpiake sipas racës dhe kategorisë.</p> <p>6.2.1. Përgatit një plan të përshtatshëm për ushqyerjen e lopës qumështore gjatë periudhës së thatë.</p> <p>6.2.2. Përgatit ushqimin për deshtë me metodën e majmërisë dhe shpjegoni veprimet e aplikuara.</p> <p>6.2.3. Përmirësoni kullotat për të ushqyer dhitë duke mbjellë kultura shtesë/ Përgatit planin për përmirësimin e kullotave për të ushqyer dhitë duke mbjellë kultura shtesë.</p> <p>6.2.3. Përgatit planin për ushqyerjen e zogjve të pulave që rriten për mish dhe shtjellojeni atë.</p> <p>6.3. Zbaton masa për mbarështimin dhe trajtimin human dhe të drejtë të kafshëve shtëpiake.</p> <p>6.3.1. Organizoni zogjtë e pulave për mish në kategori që lidhen me moshën dhe peshën.</p> <p>6.4. Zbaton masat profilaktike dhe zooteknike.</p> <p>6.4.1. Demonstroni qethjen e deleve/dhive.</p> <p>6.5. Përdor teknologjitë e mbarështimit të kafshëve shtëpiake sipas llojit dhe qëllimit të prodhimit.</p> <p>6.5.1. Kryeni mjeljen e lopëve me makinë mjelëse manuale.</p> <p>6.6. Kryen aktivitetet e duhura për grumbullimin, ruajtjen dhe magazinimin e produkteve shtazore.</p> <p>6.6.1. Përcaktoni dhe zbatoni kushtet për ruajtjen e qumështit deri në momentin e shitjes.</p>
NJËSIA 7 Përpunimi dhe ruajtja e produkteve ushqimore parësore (produkte bimore dhe blegtorale)	KEK 4	ECVET 10 - 14	<p>7.1. Përgatit lëndët e para, aksesorët, pajisjet dhe mjetet për përpunim në përputhje me standardet e përcaktuara.</p> <p>7.2. Bën përpunimin e grurit (p.sh. për prodhimin e miellit).</p> <p>7.3. Zbaton procedura të thjeshta në lidhje me trajtimin termik dhe konservimin e frutave dhe perimeve në përputhje me standardet për përfitim të produkteve (p.sh. reçel, raki, fruta dhe perime të konservuara, etj.).</p> <p>7.3.1. Zgjidhni dhe argumentoni varietetin më të përshtatshëm të rrushit dhe kryeni përpunimin paraprak për prodhimin e 5 litrave raki rrushi.</p> <p>7.3.2. Shpjegoni karakteristikat dhe llojin e pajisjeve të duhura dhe shpjegoni procesin teknologjik për prodhimin e rakisë me gradacion</p>



			<p>20 gradë.</p> <p>7.4. Prodhon perime të thata, fruta dhe lëngje të shtrydhura.</p> <p>7.5. Zbaton procesin teknologjik për prodhimin e thjeshtë të produkteve të qumështit (p.sh. djathë, kos, kefir, gjizë, krem qumështi, etj.).</p> <p>7.5.1. Shpjegoni cilësitë e nevojshme të qumështit, bazuar në analizat e kryera më parë, për prodhimin e djathit organik të Sharrit.</p> <p>7.5.2. Shpjegoni proceset teknologjike të prodhimit të djathit organik dhe llogaritni sasinë e nevojshme të qumështit për të prodhuar 5 kg djathë organik.</p> <p>7.5.4. Demonstroni fazën e parë të procesit teknologjik për prodhimin e 5 kg djathë organik të Sharrit.</p> <p>7.6. Kryen paketimin, shënjimin, ruajtjen e produkteve të gatshme dhe joprodukteve në ambalazhe të përshtatshme ekologjike.</p>
<p>NJËSIA 8 Komunikimi me bizneset dhe sipërmarrja në bujqësi</p>	<p>KEK 4</p>	<p>ECVET 7 - 8</p>	<p>8.1. Bashkëpunon në mënyrë etike dhe profesionale me eprorët, kolegët dhe palët e treta, individualisht dhe në grup, duke zbatuar teknikat e duhura të komunikimit dhe duke zgjidhur me sukses konfliktet.</p> <p>8.2. Përdor teknologjitë e informacionit në procesin e komunikimit.</p> <p>8.2.1. Përgatitni dokumentet elektronike për mallrat dhe pjesën monetare, si dhe letrat shoqëruese të biznesit për ofertën e produkteve të prodhimit bujqësor (bazuar në parametrat e përcaktuar duke përdorur aplikacionin kompjuterik).</p> <p>8.3. Përgatit një plan të thjeshtë biznesi për prodhimin dhe shitjen e produkteve bujqësore (analiza e vazhdueshme e tregut, parashikimi i tendencave të tregut, llogaritja e kostos, llogaritja e çmimit të produktit, prokurimi i materialeve dhe burimeve të nevojshme, etj.).</p> <p>8.3.1. Hartoni një formular të thjeshtë të planit të biznesit duke përdorur modelin e mëposhtëm për familjen tuaj bujqësore në lidhje me përpunimin e kumbullave të prodhuara nga ju dhe prodhimin e reçelit të cilin do ta tregtoni duke përdorur shitjet në internet dhe rrjetet sociale. Bazojeni buxhetin në prodhimin vjetor prej 2,400 kavanoza/1,000 g reçel nëse kostot totale të prodhimit janë 220,000 njësi financiare, dhe çmimi i reçelit në treg është 500 njësi financiare/kavanoz.</p> <p>MODEL I NJË PLANI BIZNESI</p> <p><b>Informacion bazë për kompaninë</b></p> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px;"> <p><b>Kompania</b></p> <p>Emri i kompanisë (mendonit një emër):</p> </div>



<b>Ideja e biznesit</b> Çfarë bën kompania?
<b>Përshkrimi i shërbimit</b> Përshkrim i shkurtër i shërbimit/produktit dhe mënyra e përdorimit të tij.
<b>Grupi i synuar (klientët)</b> Kë synoni të arrini nëpërmjet shërbimit/produktit tuaj? Cilët janë klientët/përdoruesit tuaj më të rëndësishëm të shërbimeve? Çfarë nevojash plotëson shërbimi/produkti?
<b>Realizueshmëria e idesë</b>
<b>Pjesa financiare</b> Cilat janë shpenzimet e kompanisë për kryerjen e operacioneve të saj (ndani investimet/shpenzimet për investime nga shpenzimet e rregullta të biznesit); cilat janë të ardhurat e pritshme nga shitja e produkteve/faturimi i shërbimeve tuaja. (Preferohet që të përcaktoni sasinë e kostove/të ardhurave, por nëse nuk jeni në gjendje ta bëni këtë sipas rrethanave, thjesht rendisni idetë tuaja).
<b>Teknologjia</b> A kërkon aktiviteti/produkti juaj përdorimin e disa teknologjive, pajisjeve, objekteve, mjeteve...? Si planifikoni t'i siguron ato?
<b>Marketimi dhe shitjet</b> Rendisni elementët bazë të planit të marketimit dhe mënyrën se si synoni të shisni produktin/shërbimin tuaj (përcaktoni kanalet e shpërndarjes, çmimin, metodën e promovimit të produktit/shërbimit).
<b>USP (Pika Unike e Shitjes)</b> Çfarë e dallon produktin/shërbimin tuaj nga të tjerët në treg? Analiza SWOT

**Matrica SWOT**

FAKTORËT E BRENDSHËM			
Pozitiv	Pikat e forta	Pikat e dobëta	Negativ
	Mundësitë	Kërcënime	
	FAKTORËT E JASHTËM		

8.3.2. Analizoni të dhënat e tregut të produkteve bujqësore duke përdorur metodën e duhur.

8.4. Përgatit materiale promocionale dhe promovon ofertën/produktin (në media të shkruar dhe elektronike, në panairë, etj.) duke përdorur kanale të ndryshme marketimi.



		<p>8.5. Shet me sukses produktet në treg në përputhje me planin e biznesit të përgatitur paraprakisht dhe me rregulloret në fuqi. 8.5.1.Përgatitni ofertën (përshkrimi i produktit, karakteristikat, çmimi etj.) për shitjen e reçelit të kumbullës përmes dyqanit elektronik duke përdorur një aplikacion specifik kompjuterik.</p>
<p>NJËSIA 9 Standardet, mbrojtja e mjedisit dhe siguria në punë</p>	<p>ECVET 2- 4</p>	<p>9.1. Zbaton masat e sigurisë në punë duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura mbrojtëse. 9.2. Identifikon rreziqet në procesin e punës për të reduktuar risqet/parandaluar shfaqjen e rreziqeve. 9.2.1. Zgjidhni dhe shpjegoni zgjedhjen e mjeteve dhe pajisjeve mbrojtëse më të përshtatshme që duhet të përdoren në trajtimin fitosanitar të hardhive. 9.2.2. Demonstroni përdorimin e duhur të pajisjeve mbrojtëse personale gjatë vjeljes së mjaltit në koshere.  9.3. Zbaton drejt udhëzimet e duhura gjatë përdorimit të mjeteve, pajisjeve të punës dhe produkteve të dëmshme (pesticidet).  9.4. Zbaton rregullat për mbrojtjen e mjedisit dhe standardet ekologjike. 9.4.1. Zbatoni procedurat për menaxhimin e mbetjeve të stallave blegtorale. 9.4.2. Zgjidhni bimët për mbjelljen shoqëruese/bimët shoqëruese të cilat do të sigurojnë uljen e nevojës për pesticide. Shpjegoni zgjedhjen tuaj. 9.4.3. Zgjidhni kulturën e duhur për rigjenerimin e tokës pas prodhimit konvencional si përgatitje për prodhimin organik. Shpjegoni zgjedhjen tuaj.  9.5. Menaxhon mbetjet, nënproduktet dhe kimikatet nga procesi i punës në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e mjedisit.  9.6. Zbaton standardet në prodhimin bujqësor (GAP, praktika e mirë higjienike, mirëqenia e kafshëve, prodhimi organik, prodhimi tradicional, HACCP, etj.).  9.7. Kryen operacione bujqësore duke përdorur energji dhe materiale në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit.</p>

\*Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin e vendit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

